



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
KËSHILLI KOMBTËAR



Tiranë më, 03.04.2025

V E N D I M

Nr. 9, datë 03.04.2025

Sot më datë 03.04.2025, Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, i thirrur nga Presidenti, mori në shqyrtim në rendin e ditës:

- Shqyrtimi i kërkesës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

KËSHILLI KOMBTËAR KONSTATOI SE:

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kërkon që të merret në shqyrtim nëse publikimi i masave disiplinore është i përshtatshëm, propocional dhe i kufizuar në masën e nevojshme, në raport me përmbushjen e detyrimit ligjor të Urdhrit të Psikologut në kuadër të interesit publik. Pasi mori në shqyrtim sa më sipër, Këshilli Kombëtar vlerësoi se publikimi i masës disiplinore në Regjistrin “On Line” të Anëtarëve të Urdhrit të Psikologut është në interesin më të lartë publik dhe duhet të publikohet, por kjo gjë duhet t’i adresohet për vendimmarrje Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Psikologut, si organi i cili miraton *Rregulloren për regjistrimin, anëtarësimin dhe liçencimin në Urdhrin e Psikologut të Republikës së Shqipërisë*

PËR KËTO ARSYE,VENDOSI:

- 2- Të miratojë me 10 (dhjetë) vota Pro, Asnjë Kundër nga anëtarët prezent në mbledhje të Këshillit Kombëtar adresimin për vendimmarrje të kësaj çështje në Asamblenë Kombëtare të Urdhrit të Psikologut më të afërt, si organi i cili miraton *“Rregulloren për regjistrimin, anëtarësimin dhe liçencimin në Urdhrin e Psikologut të Republikës së Shqipërisë”*.

PRESIDENTE E URDHRI

Dr. Valbona TRESKA

SEKRETARE

Arlinda KËÇI

